

# N

## JESIA ADM. FUSHË-KUQE

---

**ADMINISTRATOR : AGRON IVANAJ (PS)**

**TERRITORI**

Sipërfaqja : 62.6 km<sup>2</sup>

Koordinatat gjeografike janë: [41°38'N 19°37'E](#)

Përbëhet nga 5 fshatra : Fushë Kuqe, Patok, Adriatik, Guëz, Gorre.

Qendra e njesise adm. është fshati Fushë Kuqe

**DEMOGRAFIA**

Popullsia (Janar 2012) : 8797 banorë

Dendësia : 140 banorë/km<sup>2</sup>

Familje : 2141

Fushë Kuqe është N. Adm. që gjendet në rrethin e Kurbinit dhe që ka shumë resurse natyrore e turistike. Nj. Adm. përshkohet nga lumi Mat i cili më pas derdhet në detin Adriatik. Në fushën e Fushë-Kuqes është një zonë e rëndësishme e quajtur Laguna "Patok", e përdorur më parë si një zonë-banje. Në brendësi të lagunës komunikimi nëpër pika të ndryshme bëhet me varka, sanalle që i kanë traditë vendasit. E gjithë vija bregdetare ka një fond pyjor e ujqor mjaft të pasur me nje numër të madh speciesh të florës dhe faunës ujore që kontribuojnë në biodiversitetin, burimet ushqimore dhe vlerat estetike.

Emri "Fushë Kuqe " buron nga periudha e Gjergj Kastrioti Skënderbeut, kur gjatë betejave kundër turqve osmanë. Kjo fushë u shdërrua në një fushë të përgjakshme , të kuqe.

Në fshatin Gurëz qëndron një nga kishat më të mëdha në këtë zonë,ndërtuar me financimin e Vatikanit dhe punën e vazhdueshme të Atit Michael Bulmetti.